



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 226, datë 25.11.2021**

**MBI**

**MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ZJ. ANILA HOXHA NË POZICIONIN E  
DREJTORIT EKZEKUTIV TË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMEVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrjes, administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërive të sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

- 1. Miratimin e emërimit të zj. Anila Hoxha në pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, për një afat 4 (katër) vjeçar.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**